

Në bazë të nenit 95 pika 3 e Kushtetutës së Malit të Zi sjell,

Dekretin mbi shpalljen e Ligjit për Qasje të Lirë në Informata

Shpall Ligjin për Qasje të Lirë në Informata, të cilin e miratoi Parlamenti i Malit të Zi, në përbërjen e 24-të, në seancën e tetë të sesionit të parë të rregullt (pranveror) në vitin 2012, më 26 Korrik 2012.

Numër: 01-987/2
Podgoricë, 30 Korrik 2012

Presidenti i Malit të Zi

Filip Vujanoviq, d.v.

Në bazë të nenit 82, paragrafit 1 pika 2 dhe nenit 91 paragrafi 2 të Kushtetutës së Malit të Zi, Kuvendi i Malit të Zi, në përbërjen e 24-të, në seancën e tetë, ë sesionit të parë të rregullt (pranveror) në vitin 2012, më 26 Korrik 2012 miratoi

Ligjin për Qasjen e Lirë në Informata

1. Dispozitat e përgjithshme

Lënda

Neni 1

Të drejtën për qasje në informata të cilat posedon organi i pushtetit realizohet në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me këtë ligj.

Parimet dhe standardet

Neni 2

Qasja në informatat që posedon organi i pushtetit (në tekstin e mëtejme: qasja në informacion) bazohet në parimet e qasjes së lirë në informata, punës transparente të organit shtetëror, të drejtës së opinionit për të ditur, barazisë dhe njëjtësisë dhe realizohet në nivelin e standardeve që janë të përfshira në marrëveshjet e vërtetuara ndërkombëtare për drejtat dhe liritë e njeriut dhe rregullat e përgjithshme të pranuar të së drejtës ndërkombëtare.

Liria e qasjes në informata

Neni 3

Çdo person vendas apo i huaj, person fizik apo juridik ka të drejtë për qasje në informata, pa obligim që të deklaroj arsyet dhe të shpjegoj interesin për kërkimin e informacionit.

Transparenca në punë

Neni 4

Me qasje në informata sigurohet transparenca në punë, inkurajohet efikasiteti, efektiviteti, përgjegjshmëria dhe promovohet integriteti dhe legjitimiteti i organit të pushtetit.

E drejta e opinionit për të ditur

Neni 5

Me qasje në informata sigurohet që opinioni të dijë informatat të cilat posedon organi i pushtetit, me qëllim të kryerjes së kontrollit demokratik të pushtetit dhe realizimit të drejtave dhe lirive të njeriut.

Barazia dhe njëjtësia

Neni 6

Organet e pushtetit janë obliguara që secilit person fizik apo juridik t'i mundësojnë qasje në informata në bazë të barabartë dhe në kushte të njëjta, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Interesi publik

Neni 7

Qasja në informata është me interes publik.

Qasja në informata mund të kufizohet vetëm që të mbrojtur interesat e përcaktuara me këtë ligj.

Ndjeshmëria gjinore

Neni 8

Shprehjet të cilat përdoren në këtë ligj për personat fizik në gjininë mashkullore nënkuptojnë të njëjtat shprehje edhe në gjininë femërore.

Kuptimi i termave

Neni 9

Disa terme të posaçme në këtë Ligj kanë kuptimin si në vijim:

- 1) **organi i pushtetit** është organ shtetëror (legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, administrativ) organ i vetëqeverisjes lokale, organ i qeverisje-pushtetit lokal, institucioneve, shoqëri ekonomike apo subjekt tjetër juridik themelues ,bashkëthemelues ose pronar i shumicës është shteti ose vetëqeverisja lokale, personi juridik puna e të cilit në pjesën më të madhe financohet nga të ardhurat publike, ashtu si edhe personi fizik, sipërmarrësi ose personi juridik i cili kryen kompetencat publike ose menaxhon fondin publik;
- 2) **Informata që posedon organi i pushtetit** është posedimi faktik i informatës së kërkuar nga ana e organit të pushtetit (informata e vetë, informata e dhënë nga një organ tjetër i pushtetit ose nga një palë e tretë), pavarësisht nga baza dhe mënyra e përvetësimit.;
- 3) **Botimi i informatës** është vendosja e përmbajtjes së informatës në dispozicion;
- 4) **Zbulimi i informatave** është njohja e përmbajtjes së informatës nga parashtruesit të kërkesës ose personit tjetër që nuk është i punësuar në organin e pushtetit në posedim të cilit informata ndodhet;
- 5) **Dita e aplikimit** është dita kur kërkesa ose lutja/fletëparaqitja PODNESAK e personit fizik apo juridik është pranuar në organin e pushtetit;
- 6) **Dita e dorëzimit** është dita kur vendimi ose ndonjë akt tjetër i organit të pushtetit i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës;
- 7) **Funksionari publik** është personi që ka këtë status në pajtim me ligjin me të cilin rregullohet parandalimi i konfliktit të interesave;
- 8) **Konvertimi** është procesi i kalimit të një shkrese të caktuar-dokumenti nga forma e shtypur në formë elektronike dhe anasjelltas;

II. QASJA NË INFORMATA

Informata dhe qasja në informata

Neni 10

Informata është një dokument ose pjesë e një dokumenti në formë të shkruar, shtypur, video, me zë,elektronike apo ndonjë formë tjetër, përfshirë dhe kopjet e tyre, pavarësisht nga përmbajtja, burimi(autori), koha e përpilimi apo sistemi i klasifikimit.

Qasje në informata përfshin të drejtën për të kërkuar dhe për të pranuar informata, pavarësisht nga qëllimi dhe të dhënat të cilat të njëjtat përmbajnë.

Manual për qasje në informata

Neni 11

Organi i pushtetit është i obliguar të përpiloj, të publikoj në faqen e vet të internetit dhe që rregullisht të mirëmbaj manualin për qasje në informata që ka në posedimin e vet (në tekstin e mëtejme: Manuali për qasje në informata).

Manuali për qasjen në informata përmban një katalog të llojeve të dokumenteve, përfshirë edhe regjistrat publik dhe evidencat publike, adresën dhe adresën e e-mailit për parashtrimin e kërkesave, telefonin për kontakt, të dhënat për personat përgjegjës, shpenzimet për qasje në informata dhe të dhënat e tjera të cilat janë me vlerë për realizimin e qasjes në informata të cilat i posedon organi i pushtetit.

Organi i pushtetit është i obliguar që Manualin për qasje në informata ta mirëmbaj (rinovoj) më së paku një herë në vit, gjegjësisht në afatin prej 30 ditëve nga dita e ndryshimit të llojeve të informatave të cilat i posedon dhe të dhënave me vlerë për qasje në informata.

Organi i pushtetit është i obliguar që të lejoj qasjen në informata që disponon, edhe në qoftë se udhëzuesi për qasjen në informata nuk e përmban at informatë.

Organi i pushtetit është i obliguar që të caktoj personin i cili është i obliguar të punoj në zgjidhjen në bazë të kërkesave për qasje në informata, si dhe personin i cili do ta zëvendësoj në rast që ai do të mungoj.

Qasja proaktive në informata

Neni 12

Organi i pushtetit është i obliguar që në faqen e vet të internetit të publikoj informatat në vijim;

- 1) Manuali për qasje në informata;
- 2) Regjistrat publik dhe evidencat publike;
- 3) Programet dhe planet e punës;
- 4) Raportet dhe dokumentacionet e tjera për punën dhe gjendjen në fushat e kompetencës së vet;
- 5) Draftet, propozimet dhe tekstet e përfundimtare të dokumenteve dhe planeve strategjike dhe të programeve për zbatimin e tyre;
- 6) Draftet dhe propozimet ligjore dhe aktet tjera, si dhe mendimet e ekspertëve për këto rregulla;
- 7) Aktet e posaçme dhe kontratat për mjetet financiare në dispozicion nga të ardhurat publike dhe prona shtetërore;
- 8) Regjistrimin e zyrtarëve dhe nëpunësve shtetëror, me titujt e tyre si zyrtarë dhe nëpunës;
- 9) Listën e funksionarëve publik dhe listën e llogaritjes të ardhurave të tyre mujore dhe të ardhurave të tjera dhe kompensimeve lidhur me kryerjen e funksionit publik;
- 10) Vendimet dhe aktet e tjera të veçanta të cilat janë me rëndësi për të drejtat, detyrat dhe interesat e personave të tretë;
- 11) Informatën në të cilën sipas kërkesës është miratuar qasja.

Organi i pushtetit është i obliguar që informatat nga paragrafi 1 i këtij neni ti publikoj në afatin prej 15 ditësh nga dita e përpilimit ose nxjerrjes, gjegjësisht të miratimit.

Organi i pushtetit mund të publikoj në faqen e vet të internetit edhe informatat e tjera të cilat nuk janë përfshirë me paragrafin 1 të këtij neni.

Në rast të publikimit të informatave, organi i pushtetit është i obliguar që në mënyrë të duhur të mbrojë të dhënat personale të cilat janë me rëndësi për privatësinë dhe të dhënat të cilat janë shënuar me shkallën e fshehtësisë, në pajtim me ligjin.

Qasja në informata me kërkesë

Neni 13

Organi i pushtetit është i obliguar në bazë të kërkesës për qasje në informatë që personit fizik apo juridik (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) t'i mundësoj qasjen në informatë që posedon ose në një pjesë të saj, përveç në rastet e parapara me këtë ligj.

Kufizimi i qasjes në informata

Neni 14

Organi i pushtetit mund të kufizoi qasjen në informatë ose në një pjesë të informatës, nëse kjo është me interes të :

- 1) Mbrojtjes së privatësisë nga publikimi i të dhënave të parapara me ligjin me të cilin rregullohet mbrojtja e të dhënave mbi personin, përveç të dhënave që kanë të bëjnë me:
 - funksionarët publik lidhur me kryerjen e funksionit publik, si dhe të ardhurat, pasurinë dhe konfliktin e interesave të këtyre personave dhe të familjarëve të tyre të cilët janë të përfshirë me ligjin me të cilin rregullohet parandalimi i konfliktit të interesit;
 - mjetet e ndara nga të ardhurat publike, përveç pagave sociale, mbrojtjen shëndetësore dhe mbrojtjen nga papunësia,
- 2) Sigurisë, mbrojtjes, politikës së jashtme, monetare dhe ekonomike të Malit të Zi, në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet fshehtësia e të dhënave, të shënuara me shenjën e fshehtësisë;
- 3) Parandalimit të hetimit dhe të përndjekjes së autorëve të veprave penale, me qëllim të mbrojtjes nga publikimi i të dhënave që kanë të bëjnë me :
 - Parandalimin e kryerjes së veprave penale;
 - Paraqitjen e veprës penale dhe të autorit të saj;
 - Përmbajtjen e veprimeve të marra gjatë procesit parapenal dhe penal;
 - Faktet e grumbulluara në teren dhe me hetime;
 - Masat e mbikëqyrjes së fshehtë;
 - Dëshmitarin e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunëtor;
 - Efikasitetin e udhëheqjes së procesit;

- 4) Ushtrimit të detyrës zyrtare, me qëllim të mbrojtjes nga publikimi i të dhënave të cilat kanë të bëjnë me:
- Planifikimin e kontrollit të inspektoratit dhe mbikëqyrjen nga ana e organit shtetëror;
 - Konsultimet brenda dhe në mes të organeve të shtetërore lidhur me përcaktimin e qëndrimeve me qëllim të hartimit të dokumentit zyrtar dhe propozimit të zgjidhjes të ndonjë lënde;
 - Punën dhe vendimmarrjen e organeve kolegjiale;
 - Nisjen dhe udhëheqjen e procedurës disiplinore;
- 5) mbrojtjen e interesave tregtare dhe interesave të tjera ekonomike nga publikimi i të dhënave të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës dhe fshehtësisë afariste lidhur me të drejtën e pasurisë intelektuale.

Kohëzgjatja e kufizimit

Neni 15

Kufizimi i qasjes në informatë me qëllim të mbrojtjes së privatësisë dhe informatës e cila përmban të dhënat mbi dëshmitarin e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunëtorë zgjatë 70 vjet nga momenti i deklarimit dhe 20 vjet nga vdekja e personit me të cilin ka të bëjë, përveç nëse personi me të cilin ka të bëjë informacioni ose bashkëshorti/ja, fëmijët ose prindërit pas vdekjes së personit pranojnë që informacioni të publikohet më parë.

Kufizimi i qasjes në informatë me qëllim të sigurisë, mbrojtjes, politikës së jashtme, monetare dhe ekonomike e Malit të Zi mund të zgjasë deri në përfundim të afateve të cilat janë përcaktuar me ligj me të cilin rregullohet fshehtësia e të dhënave.

Kufizimi i qasjes në informatë me qëllim të parandalimit të hetimit dhe përndjekjes së autorit të veprave penale mund të zgjasë më së largu deri në përfundim të procesit.

Kufizimi i qasjes në informatë me qëllim të kryerjes së detyrës zyrtare mund të zgjasë deri në hartim të dokumentit zyrtar ose përcaktimit të propozimit të zgjidhjes së ndonjë lënde, verifikimit të proces verbalit nga mbledhja e organit të kolegjial dhe përfundimi i procesit disiplinor.

Kufizimi i qasjes në informatë me qëllim të mbrojtjes së interesave tregtare dhe interesave të tjera ekonomike zgjatë deri në skadimin e afatit në pajtim me ligjin me të cilin rregullohen të drejtat e pasurisë intelektuale.

Testi i dëmit për zbulimin e informatave

Neni 16

Qasja në informatë do të kufizohet nëse publikimi i informatës dukshëm rrezikon interesin nga neni 14 i këtij ligji, gjegjësisht nëse ekziston mundësia që publikimi i informatës do të shkaktonte pasoja negative për interesin i cili

është më i rëndësishëm se interesi që publiku të dinë atë informatë, vetëm nëse interesi publik mbizotëron siç është përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji.

Testimi i dëmit nuk bëhet për informatat nga neni 14, pika 1, alineja 1 dhe 2 e këtij ligji.

Për kërkesën për qasje në informatë e cila përmban të dhëna të cilat janë shënuar me shenjën e shkallës së fshehtësisë, organi i pushtetit vendos sipas pëlqimit të organit të pushtetit i cili e ka përcaktuar fshehtësinë e të dhënave.

Në rastin nga paragrafi 3 i këtij neni, organi i pushtetit i cili ka përcaktuar fshehtësinë e të dhënave është i obliguar që në afatin prej 10 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për dhënien e pëlqimit, organit të pushtetit i cili vendos sipas kërkesës për qasjen në informata t'i dorëzoj aktin e përshtatshëm.

Për të dhënat që përmban informata e cila është nga shteti tjetër ose organizata ndërkombëtare është shënuar me shkallën e fshehtësisë nuk kryhet testi i dëmit.

Mbizotërimi i interesit publik

Neni 17

Mbizotërimi i interesit publik për publikimin e informatës ose një pjesë të saj ekziston kur informata e kërkuar përmban të dhëna të cilat në mënyrë të arsyeshme tregojnë për:

- 1) Korrupsion, mosrespektim të rregullave, përdorimin e paligjshëm të fondeve publike dhe abuzim të kompetencave gjatë ushtrimit të funksionit publik;
- 2) Dyshim se është kryer një vepër penale ose ekzistimin e arsyeve për të kontestuar vendimin e gjykatës;
- 3) Përfitimim ose shpenzimin e paligjshëm të mjeteve nga fondet publike;
- 4) Kërcënim për sigurinë publike;
- 5) Kërcënim për jetën;
- 6) Kërcënim për shëndetin publik;
- 7) Kërcënim për mjedisin jetësor;

Organi i shtetit është i obliguar që të lejoj qasjen në informatë ose në pjesë të informatës nga neni 14 i këtij ligji kur mbizotëron interesi publik për publikimin e saj.

III. Procedura për qasje në informata

Nisja e procedurës

Neni 18

Procedura për qasje në informatë nisët me kërkesë me shkrim ose me gojë të personit që kërkon qasje në informatë.

Me një kërkesë mund të kërkohet qasja në më shumë informata.

Kërkesa me shkrim për qasje në informatë i dorëzohet organet të shtetit drejtpërdrejtë, me postë ose në mënyrë elektronike (faks, e-mail, etj.).

Kërkesa me gojë për qasje në informata i dorëzohet organit të pushtetit drejtpërdrejtë në procesverbal, kurse organi i pushtetit është i detyruar që kërkesë ta pranojë pa e shtyrë afatin.

Organi i pushtetit është i obliguar që parashtruesit të kërkesës t'i lëshoj ose dorëzoj dëshminë përkatëse se e ka pranuar kërkesën për qasje në informatë.

Përmbajtja e kërkesës

Neni 19

Kërkesa për qasje në informata duhet të përmbajë:

- 1) Emrin e informatës ose të dhënat në bazë të cilave ajo mund të identifikohet;
- 2) Mënyrën se në cilën formë dëshirohet të realizohet qasja në informatë;
- 3) Të dhënat për parashtruesin e kërkesës (emrin, mbiemrin dhe adresën e personit fizik, ose emrin dhe adresën e personit juridik), gjegjësisht të të agjentit, përfaqësuesit apo avokatit të tij.

Parashtruesi i kërkesës mund të theksoj në kërkesë edhe të dhëna të tjera për të cilat konsideron se janë të rëndësishme për realizimin e qasjes në informatë.

Organi i pushtetit mund përpiloj formën e kërkesës për qasje në informatë, mirëpo është i obliguar të veproj edhe sipas kërkesës e cila nuk është parashtruar në këtë formë.

Ndihma parashtruesit të kërkesës

Neni 20

Organi i pushtetit është i obliguar që, në pajtim me kompetencat e veta, t'i ndihmoj parashtruesit të kërkesës që të realizoj qasje në informatën e kërkuar.

Nëse kërkesa për qasje në informatë nuk është e plotë ose është e pakuptueshme dhe për këtë i njëjti nuk mund të trajtohet, organi i pushtetit është i obliguar që të ftoj parashtruesin e kërkesës që, në afatin prej tetë ditëve nga dita e aplikimit të kërkesës, të shmang mangësitë në kërkesë dhe t'ia drejtoj që të eliminoj mangësitë në kërkesë.

Në rastin e pikës së 2 të këtij neni, afati i zgjidhjes fillon nga dita e parashtrimin të kërkesës së korrigjuar.

Nëse organi i pushtetit nuk posedon informatat e kërkuara është i obliguar që, pa shtyrje, nëse dinë se cili organ është përgjegjës për të vepruar në kërkesën për qasje në informatë, që të dërgojë kërkesën organit shtetëror kompetent dhe për këtë të informoj parashtruesin e kërkesës.

.....

Mënyrat e qasjes në informatë

Neni 21

Parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të zgjedhin mënyrën në të cilën dëshiron të realizoj qasjen në informatën e kërkuar, dhe me:

- 1) Vështrim të drejtpërdrejtë të origjinalit ose kopjes së informatës në lokalet e administratës shtetërore;
- 2) Transkriptim ose skenim të informatës nga ana e parashtruesit të kërkesës në lokalet e administratës shtetërore;
- 3) Dorëzim të kopjes së informatës parashtruesit të kërkesës nga ana e administratës shtetërore, me postë ose në mënyrë elektronike;

Organi i pushtetit është i obliguar që t'i mundësoj qasje në informatë në mënyra nga paragrafi 1 i këtij neni për të cilën parashtruesi i kërkesës është përcaktuar, përveç nëse mënyra e kërkuar e qasjes nga ana teknike nuk është e mundur.

Me qëllim të mundësimin të qasjes në informatë në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të dëshiroj, organi shtetëror është obliguar që të zbatoj, kur kjo është e mundur, konvertimin e formatit ekzistues të informatës në elektronike, gjegjësisht në formë analoge (skenim, kopjim).

Format e qasjes në regjistrat publik dhe evidencat publike

Neni 22

Qasja në regjistrim publik dhe evidencë publike mundëson që drejtpërdrejtë në bazë të kërkesës së shkruar ose gojore, pa nxjerrjen e vendimit, me vështrimin e të njëjtave në lokalet e organit shtetëror.

Organi i pushtetit është i obliguar që parashtruesit të kërkesës t'i mundësoj vështrimin e regjistrat publik dhe evidencës publike, në afat prej 5 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës dhe për këtë të përpiloj shënimin zyrtarë.

Mënyrat e qasjes në informata për personat me invaliditet

Neni 23

Personit me invaliditet i mundësohet qasja në informatë në mënyrë dhe formë e cila i përgjigjet mundësisë dhe nevojave të tij.

Mënyrat e qasjes në një pjesë të informatës

Neni 24

Nëse qasja në një pjesë të informatës është e kufizuar, në pajtim me nenin 14 të këtij ligji, organi i pushtetit është i obliguar që të mundësoj qasjen

në informatë me dorëzimin e kopjes së saj parashtruesit të kërkesës, pas fshirjes së pjesës së informatës në të cilën qasja është e kufizuar.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, në pjesën e informatës në të cilën qasja është e kufizuar vendoset vërejtja “është bërë fshirja” dhe jepet informata mbi sasinë e fshirjes së kryer (rendeve, pasuseve dhe faqeve).

Fshirja e një pjese të informatës kryhet në mënyrë me të cilën nuk mund të asgjësohet ose dëmtohet teksti, gjegjësisht përmbajtja e informatës.

Organi kompetent i pushtetit

Neni 25

Për vendimin në bazë të kërkesës për qasje në informatë kompetent është organi i pushtetit i cili posedon informatat e kërkuara.

Personi juridik, ndërmarrësi ose personi fizik i cili, në pajtim me nenin 9 pika 1 e këtij ligji, konsiderohet organ shtetëror sepse kryen kompetencat publike dhe administron fondin publik është i obliguar të mundësoj qasjen në informata të cilat posedon dhe të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e kompetencave publike apo administrimin e fondeve publike.

Qasja në informatë të publikuar në opinion

Neni 26

Organi i pushtetit nuk është i obliguar që me anë të e-mailit të mundësoj qasjen në informatë të cilën e posedon, nëse ajo nuk është publikuar në opinion në Mal të Zi ose nuk është e mundur qasja në faqen e internetit të organit të pushtetit.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni organi shtetëror është i obliguar që, në afatin prej 5 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës, në formë të shkruar, të njoftoj parashtruesin e kërkesës mbi atë se ku dhe kur informata e kërkuar është publikuar në opinion.

Rregullat e procedurës

Neni 27

Organi i pushtetit vendos në bazë të kërkesës për qasje në informatë sipas rregullave të përgjithshme të procedurës administrative, pa zbatimin e diskutimit verbal, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Anulimi i kërkesës

Neni 28

Organi i pushtetit do të anuloj kërkesën për qasje në informatë nëse parashtruesi i kërkesës nuk do të veproj në pajtim me nenin 20 të këtij ligji.

Refuzimi i kërkesës

Neni 29

Organi i pushtetit do të refuzoj kërkesën për qasje në informatë, nëse:

- 1) Qasja në informatë kërkon apo nënkupton përpilimin e informatës së re;
- 2) Parashtruesit të kërkesës i është mundësuar qasja në të njëjtën informatë gjatë gjashtë muajve të kaluar;
- 3) Ekziston arsyeja nga neni 14 i këtij ligji për kufizimin e qasjes në informatën e kërkuar;

Zgjidhja sipas kërkesës

Neni 30

Për kërkesën për qasje në informatë, përveç në rastin nga neni 22 i këtij ligji, organi shtetëror vendos me vendimin, me të cilin lejohet qasja në informatën e kërkuar ose një pjesë të saj ose nëse kërkesa refuzohet.

Me vendimin me të cilin lejohet qasja në informatë ose në një pjesë të saj përcaktohet:

- 1) Mënyra në të cilën lejohet qasja në informatë;
- 2) Afati për realizimin e qasjes;
- 3) Shpenzimet e qasjes;

Vendimi me të cilin refuzohet kërkesa për qasje në informatë përmban arsyetimin e shkaqeve për të cilat nuk lejohet qasja në informatën e kërkuar.

Afati për zgjidhjen sipas kërkesës

Neni 31

Organi i pushtetit është i obliguar që mbi kërkesën për qasje në informatë të marrë vendimin dhe t'ia dorëzoj parashtruesit të kërkesës, në afatin prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës së rregullt.

Nëse qasja në informatë kërkohet për të mbrojtur jetën ose lirinë e personit, organi i pushtetit është i obliguar që për vendimin mbi kërkesën ta marrë dhe dorëzoj parashtruesit të kërkesës në afatin prej 48 orëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës.

Afatin nga paragrafi 1 të këtij neni organi i pushtetit mund ta shtyjë deri në 8 ditë, nëse:

- 1) Kërkohe qasja për një informatë shumë voluminoz;
- 2) Kërkohe qasje për informatë e cila është shënuar shkallën e fshehtësisë;
- 3) Gjetja e informatës së kërkuar kërkon hulumtimin e një numri më të madh të informatave, çka dukshëm çon deri tek vështirësimi i punës së rregullt të organit shtetëror.

Në rastet nga paragrafi 3 i këtij neni, organi shtetëror është i obliguar që, në afatin prej 5 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës, në formë të shkruar, të njoftoj parashtruesin e kërkesës për zgjatjen e afatit për vendimin në bazë të kërkesës,

Afati për ekzekutimin e zgjidhjes

Neni 32

Organi i pushtetit është i obliguar të ekzekutoj vendimin me të cilin lejohet qasja në informatë në afatin prej ditë pune nga dita e dorëzimit të vendimit parashtruesit të kërkesës, gjegjësisht në afatin prej 5 ditësh nga dita kur parashtruesi i kërkesës i ka dorëzuar faktet mbi pagesën e shpenzimeve të procesit, nëse ato janë të përcaktuara me vendim.

Shpenzimet e procesit

Neni 33

Me kërkesë për qasje në informatë nuk paguhet taksa.

Parashtruesi i kërkesës mbulon shpenzimet e procesit për qasje në informatë i cili ka të bëjë me shpenzimet reale të organit shtetëror për kopjim, skenim dhe dorëzim të informatave të kërkuara, në pajtim me dispozitat e Qeverisë së Malit të Zi.

Me dispozitat nga paragrafi 2 i këtij neni mund të përcaktohen shpenzimet e posaçme për qasje në informata në arkiva, biblioteka dhe muzetë të cilat paraqesin të dhënat arkivore dhe të bibliotekave, gjegjësisht materialin e muzeve.

Nëse parashtruesi i kërkesës është person me invaliditet dhe person në gjendje të nevojës sociale, shpenzimet e procesit për qasje në informatë i mbulon organi i pushtetit.

Shpenzimet e procesit nga paragrafi 2 i këtij neni paguhen para mundësimit të qasjes në informatë.

Nëse parashtruesi i kërkesës nuk paraqet dëshminë se ka paguar shpenzimet e procesit në vlerën e caktuar, organi shtetëror nuk do t'i mundësoj qasjen në informatën e kërkuar.

E drejta në ankesë

Neni 34

Kundër aktit të organit të pushtetit mbi vendimin për qasje në informatë parashtruesi i kërkesës dhe personi tjetër i interesuar mund të deklaroj ankesë organit të pavarur mbikëqyrës kompetent për mbrojtjen e të dhënave të personit dhe qasjen në informata. Agjencia për mbrojtjen e dhënave për personin(personalitetin) dhe qasje në informata (në tekstin e mëtejme: Agjencia), përmes organit të pushtetit i cili ka vendosur në bazë të kërkesës në shkallën e parë.

Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kundër vendimit me të cilin është refuzuar kërkesa për qasje në informatë e cila përmban të dhënat të cilat janë të shënuara me shkallën e fshehtësisë nuk mund të deklarohet ankesa, mirëpo me ankesë mund të nisët procesi administrativ.

Arsyet për ankesë

Neni 35

Ankesa kundër aktit në bazë të kërkesës për qasje në informatë mund të deklarohet për shkak të shkeljes së rregullave të procesit, gjendjes faktike të padrejtë dhe jo të plotë dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

Efekti i ankesës

Neni 36

Ankesa në vendimin me të cilin lejohet qasja në informatë nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Veprimi i organit të shkallës së parë sipas kërkesës

Neni 37

Organi i shkallës së parë është i obliguar që, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligjin me të cilin rregullohet procesi administrativ, të zbatoj të gjitha veprimet sipas ankesë, në afatin prej pesë ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës.

Veprimi i Agjencisë sipas ankesës

Neni 38

Agjencia është e obliguar që në bazë të ankesës në aktin për kërkesë për qasje në informatë të nxjerrë vendimin dhe t'ia dorëzoj parashtruesit të kërkesës, në afatin prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të ankesës.

Mbi ankesën në aktin për kërkesën për qasje në informatë vendos organi i administrimit të Agjencisë (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli i Agjencisë).

Kompetencat e Agjencisë

Neni 39

Agjencia, krahas kompetencave të cilat janë përcaktuar me ligjin me të cilin rregullohet mbrojtja e të dhënave personale:

- 1) Kryen kontrollin e ligjshmërisë së akteve administrative me të cilat vendoset për kërkesat për qasje në informatë dhe ndërmerr masat e parapara me ligj;
- 2) Udhëheq sistemin e informacionit për qasje në informata;
- 3) Përcjell gjendjen në fushën e qasjes në informacion;
- 4) Kryen inspektimin mbi zbatimin e këtij ligji në raport me përpilimin dhe mirëmbajtjen e guidës (udhërrëfyesit) për qasje në informata, në mënyrë proaktive publikon informatat, dorëzon aktet dhe të dhënat për nevojat e udhëheqjes së sistemit të informacionit për qasje në informata.
- 5) Parashtron kërkesat për nisjen e procesit për kundërvajtje për shkeljen e dispozitave të këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me përpilimin dhe mirëmbajtjen e guidës (udhërrëfyesit) për qasje në informata, në mënyrë proaktive publikon informatat, dorëzon aktet dhe të dhënat për nevojat e udhëheqjes së sistemit të informacionit për qasje në informata.
- 6) Kryen edhe punët e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Kompetencat e Këshillit të Agjencisë

Neni 40

Me qëllim të vendosjes sipas ankesës dhe kryerjes së mbikëqyrjes së akteve administrative sipas kërkesave për qasje në informata, Këshilli i Agjencisë ka të drejtë të kërkojë që:

- 1) Organi i pushtetit të japin informatën e plotë ose një pjesë të informatës me të cilën kërkohet qasja, si dhe informata të tjera e të dhëna të tjera të cilat janë të nevojshme për të vendosur;
- 2) Inspektorati i cili është kompetent për kontrollin e veprimtarisë zyrtare të përcaktoj se a posedon organi shtetëror informatën e kërkuar;
Organi i pushtetit dhe inspektorati nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar që, në afatin prej pesë ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës, t'i japin Këshillit të Agjencisë informatat dhe të dhënat e kërkuara.

Sistemi i informacionit për qasje në informatë

Neni 41

Për të përcjell gjendjen në fushën e qasjes në informata Agjencia udhëheq sistemin informativ për qasje në informata, me të cilin sigurohet baza e të dhënave për:

- 1) Organin e pushtetit;
- 2) Kërkesat për qasje në informata, sipas parashtruesve, organeve të pushtetit, llojeve të informatave dhe mënyrave të kërkuara për qasje në informata;
- 3) Aktet e organit shtetëror sipas kërkesave për qasje në informatë;
- 4) Ankesat në aktet sipas kërkesave për qasje në informatë, sipas parashtruesve dhe organeve shtetërore;
- 5) Ankesa kundër vendimeve për kërkesat për qasje në informata, sipas parashtruesve të ankesës dhe organeve shtetërore të paditura;
- 6) Vendimet e gjykatës sipas ankesave në vendimet e dhëna në kërkesat për qasje në informata;
- 7) Masat kundër organit të pushtetit për mosveprimin në pajtim me këtë ligj; Përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së sistemit informativ e përcakton ministria e cila është kompetente për punët e administratës shtetërore.

Obligimet e dorëzimit të akteve dhe të dhënave

Neni 42

Organet e pushtetit janë të obliguara që t'i parashtrojnë Agjencisë të dhënat për ankesat, aktet dhe masat që kanë ndërmarrë nga neni 41 paragrafi 1 i këtij ligji, në afatin prej 10 ditëve nga dita e parashtrimit të tyre, gjegjësisht përpilimi dhe koha kur janë ndërmarr.

Raporti mbi gjendjen në fushën e qasjes në informatë

Neni 43

Këshilli i Agjencisë është i obliguar që një herë në vit t'i jap raportin Kuvendit të Malit të Zi për masat që kanë ndërmarr në fushën e qasjes në informata.

Krahas obligimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli i Agjencisë është i obliguar t'i jap raportin Kuvendit çdoherë kur Kuvendi të kërkoj.

Mbrojtja gjyqësore

Neni 44

Parashtruesi i kërkesës për qasje në informatë dhe personi tjetër i interesua ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore, në pajtim me ligjin me të cilin rregullohet mosmarrëveshja administrative.

Gjyqi ka të drejtë të vlerësoj se a i ka shënuar organi shtetëror në mënyrë të drejtë me shkallën e fshehtësisë, në pajtim me ligjin i cili rregullon fshehtësinë e të dhënave, të dhënat në informatën për të cilën kërkohet qasja.

Procedura sipas ankesës lidhur me qasjen në informatë është urgjente.

Mbrojtja e punësuarit

Neni 45

I punësuarit në organin e pushtetit i cili, duke kryer detyrën me përgjegjësi, publikon informatën e cila përmban të dhëna për keqpërdorin apo parregullsi në kryerjen e funksionit publik apo kompetencave zyrtare nuk mund të thirret për shkelje të detyrës në punë.

IV MBIKËQYRJA

Inspektimi

Neni 46

Inspektimin e zbatimit të këtij ligji e bënë e bënë ministria e cila është kompetente për punët e administratës shtetërore, përveç inspektimit në bazë të nenit 39 paragrafi 1 pika 4 e këtij ligji.

V DISPOZITAT NDËSHKUESE

Shkeljet për autoritetet e pushtetit

Neni 47

Me gjobë me para prej 500 euro deri 20.000 euro do të dënohet për kundërvajtje juridike personi i cili:

- 1) Nuk përpilon, nuk boton ose rregullisht, e së paku një herë në vit, nuk rinovon guidën për qasje në informata (neni 11 paragrafi 1);
- 2) Në faqen e vetë të internetit nuk boton informatat të cilat është i obliguar t'i botoj (neni 12 paragrafi 1);
- 3) Nuk i mundëson parashtruesit të kërkesë qasjen në informatë ose në një pjesë të saj, përveç në rastet e parashikuara me këtë ligj (neni 13);
- 4) Nuk mundëson qasjen në informatë publikim i të cilës është me interes të pjesës më të madhe të opinionit, përveç nëse nuk dëshmohet se ekziston interes tjetër më i rëndësishëm publik (neni 17, paragrafi 2);
- 5) Parashtruesit të kërkesës i cili kërkon këtë nuk i jepet ose nuk paraqet dëshmi adekuate se ka pranuar kërkesën për qasje në informatë (neni 18, paragrafi 5);

- 6) Nuk fton parashtruesin e kërkesës që të mënjanoj lëshimet në kërkesë dhe nuk i jep udhëzimin se si të mënjanoj këto lëshime (neni 20, paragrafi 2);
- 7) Nuk i mundëson parashtruesit të kërkesës qasjen në informatë në mënyrë në të cilën ai dëshiron, përveç nëse mënyra e kërkuar teknikisht nuk është e mundur ose kur e kryen, kur kjo është e mundur dhe e zbatueshme, konvertimi i formatit të informatës në formë elektronike, gjegjësisht formë analoge (neni 21, paragrafët 2 dhe 3);
- 8) Nuk i mundëson parashtruesit të kërkesës qasjen në regjistrin ose evidencën publike në afatin prej pesë ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës (neni 22, paragrafi 2);
- 9) Nuk e njofton, në formë të shkruar, parashtruesin e kërkesës, në afatin prej pesë ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës, për atë se ku dhe kur është botuar informata e kërkuar (neni 26, paragrafi 2);
- 10) Për kërkesën për qasje në informatë nuk miraton vendimin dhe të njëjtin nuk i dorëzon parashtruesit të kërkesës, në afatin prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës (neni 31, paragrafi 1);
- 11) Në rast të zgjatjes së afatit për miratimin dhe dorëzimin e vendimit në bazë të kërkesës për qasje në informatë nuk e njofton, më formë të shkruar, parashtruesin e kërkesës, në afatin prej pesë ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës, për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit në bazë të kërkesës (neni 31, paragrafi 4);
- 12) Nuk ekzekuton vendimin me të cilin lejohet qasja në informatë, në afatin prej pesë ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit parashtruesit të kërkesës, gjegjësisht nga dita kur parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar dëshminë për pagesën e shpenzimeve të procedurës, nëse ato janë të përcaktuara me vendim (neni 32);
- 13) Si organ i shkallës së parë nuk vepron sipas ankesës kundër aktit për kërkesë për qasje në informatë në afatin prej pesë ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës (neni 37);
- 14) Nuk i dorëzon Këshillit të Agjencisë informatat dhe të dhënat e kërkuara, në afatin prej pesë ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës (neni 40, paragrafi 2);
- 15) Nuk i dorëzon Këshillit të Agjencisë të dhënat për ankesat, aktet dhe masat nga neni 41 paragrafi 1 i këtij ligji, në afatin prej 10 ditëve nga dita e dorëzimit të tyre, gjegjësisht përpilimi apo koha kur janë ndërmarr (neni 42);
- 16) Thërret në përgjegjësi të punësuarin i cili, duke kryer detyrën me përgjegjësi, publikon të dhënat për keqpërdorin apo parregullsi në kryerjen e funksionit publik apo kompetencave zyrtare (neni 45);
Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të gjobitet edhe personi përgjegjës në subjektin juridik, organin shtetëror, organin e vetëqeverisjes lokale, organin e qeverisjes lokale dhe personi fizik me gjobë me para prej 200 euro deri në 2000 euro.
Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni sipërmarrësi do të gjobitet me gjobë me para prej 150 euro deri në 6000 euro.

Shkeljet për Agjencinë

Neni 48

Me gjobë me para prej 200 euro deri në 2000 euro do të dënohet për kundërvajtje Agjencia, si person juridik, nëse:

- 1) Nuk miraton vendimin sipas ankesës dhe nuk i dorëzon parashtruesit të ankesës, në afatin prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës dhe nëse Këshilli i Agjencisë nuk vendos sipas meritave lidhur me ankesën (neni 38, paragrafët 1 dhe 3);
 - 2) Nuk i jep Kuvendit të Malit të Zi raportin për gjendjen në fushën e qasjes në informata (neni 43);
- Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni do të gjobitet edhe personi përgjegjës në Agjenci me gjobë me para prej 200 euro deri në 2000 euro.

VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Afati për përpilimin e manualit për qasje në informata

Neni 49

Manualet për qasje në informata, në pajtim me këtë ligj, organet shtetërore do t'i përpilojnë dhe do t'i publikojnë në faqen e vetë të internetit në afatin prej 30 ditësh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Aktet nënligjore

Neni 50

Aktet nënligjore në pajtim me këtë ligj do të miratohen në afatin prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Krijimi i një sistemi të informacionit

Neni 51

Sistemi informativ i qasjes në informata do të vendoset në afatin prej 90 ditësh nga dita e miratimit të aktit nënligjor nga neni 41 paragrafi 2 i këtij ligji.

Procedurat e filluara

Neni 52

Procedurat për qasje në informata të cilat janë fillua para fillimit të këtij ligji do të përfundohet në bazë të ligjit të mëparshëm.

Pushimi i dispozitës së mëparshme

Neni 53

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji pushon të jetë në fuqi Ligji për qasje të lirë në informata (“Gazeta Zyrtare e RMZ”, numër 68/05).

Hyrja në fuqi

Neni 54

Ky ligj hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Malit të Zi”, kurse do të zbatohet me skadimin e afatit prej gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi.

Numër 23-3/12-4/10
EPA 888 XXIV
Podgoricë, 26 Korrik 2012

Kuvendi i Malit të Zi, përbërja e 24-të
Kryetari
Ranko Krivokapiq, d.v.